



## Ministria e Pushtetit Lokal dhe Asociacioni i Komunave kanë nënshkruar Memorandumin e Mirëkuptimit

Ministria e Pushtetit Lokal dhe Asociacioni i Komunave të Kosovës kanë nënshkruar Memorandumin e Mirëkuptimit për bashkëpunim mes këtyre dy institucioneve. Ky memorandum është përparim me qëllim të qartësimit të parimeve të bashkëpunimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve mes Ministrisë së Pushtetit Lokal dhe Asociacionit të Komunave të Kosovës. Me gjithë njohjen e ndryshimeve të funksioneve dhe statusit ligjor të këtyre dy institucioneve, ky memorandum synon të promovojë përpjekje të përbashkëta të MPL-së dhe AKK-së për të arritur një vetëqeverisje demo-kratike e stabile në Kosovë. Me këtë Memorandum specifikohet që AKK-ja është përfaqësues i komunave i bazuar në pjesëmarrjen vullnetare dhe interesin e përbashkët. Nënshkrimi i këtij memorandum është me rëndësi të madhe sepse në parimet e përbashkëta të këtyre dy institucioneve ceket synimi i për-



bashkët për të promovuar Kartën Evropiane të Këshillit të Evropës për Vetëqeverisjen Lokale edhe në Kosovë. Ministria e Pushtetit Lokal do të ftojë përfaqësuesit e AKK në çdo grup punues që lidhet me reformat në qeverisjen lokale si dhe do të bëjë përpjekje për të përfshirë AKK në ndonjë proces tjetër legjislativ, të iniciuar nga Ministri të tjera ose nga Parlamenti, që mund të ketë ndikim në interesat e komunave. AKK do t'i japë këshilla MAPL për ndonjë proces dia-

logu me Ministri të tjera të Qeverisë që kanë ndikim në politikat e vetëqeverisjes lokale në Kosovë. AKK-ja do të përkrahë MAPL-në gjatë informimit të komunave rreth propozimeve legjislative të përgatitura nga Qeveria dhe që kanë ndikim tek komunat. Memorandumin e Mirëkuptimit mes Ministrisë së Pushtetit Lokal e Asociacionit të Komunave të Kosovës e kanë nënshkruar ministri i MPL-së z.Lufti Haziri dhe u.d. kryetarit të AKK-së z.Ismet Beqiri.

### DEKLARUAN:

Ministri i Pushtetit Lokal z.Lufti Haziri tha se "Përmes këtij dokumenti kemi krijuar rrugën tonë të përbashkët të involvimit të të zgjedhurve lokalë dhe ekspertëve lokalë në të gjitha forumet e mekanizmat qeveritar që reflektojnë interesin lokal të komunave të Kosovës. Aq më shumë kur pritet të hyjmë në ndërtimin e infrastrukturës ligjore në Kosovë për pushtetin lokal"

Ushtrues i detyrës i kryetarit të Asociacionit të Komunave të Kosovës z.Ismet Beqiri - tha se "vetë fakti se problemet e qytetarëve janë probleme praktike është shkalla e parë ajo e komunave të ballafaqohen me sfidat me problemet që i kanë qytetarët . Partnerë më të mirë se vet MPL-ja dhe Qeveria nuk mund të kemi, dhe kjo është e një rëndësie të veçantë"

## Konferenca e sigurisë së komunitetit dhe policisë në komunitet



Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) në bashkëpunim me projektin e DFID-it (Policia në komunitet dhe siguria e komunitetit) dhe me OSBE-në kanë organizuar konferencën mbi promovimin e sigurisë së komunitetit. Ky aktivitet i organizuar përkrahë në mënyrë direkte standardin e II-të të Planit për Zbatimin e Standardeve në Kosovë, që kërkon nga të gjitha komunat

të zhvillojnë dhe zbatojnë strategjinë e sigurisë së komunitetit dhe nën standardin 5.2. Sa i përket sigurisë së komunitetit, është qenësore që të gjitha institucionet e Kosovës, duke përfshirë edhe organet e nivelit komunal dhe policinë të sigurojnë pjesëmarrjen e plotë të të gjitha komuniteteve. Kjo do të siguroj se strategjitë dhe politikat e sigurisë do të mbrojnë të drejtat e atyre komu-

niteteve dhe me saktësi do të reflektojnë nevojat e tyre. Në këtë konferencë dy ditore përveç kryetarëve të Komunave dhe përfaqësuesve të DFID-it e OSBE-së kanë marrë pjesë edhe znj. Melihate Tërmkollli, Ministre e Ministrisë të Shërbimeve Publike e z. Lufti Haziri Ministri i Ministrisë së Qeverisë Lokale dhe kolonelë, nënkolonelë dhe major të SHPK-së.

## REAGIME e DEKLARATA

### Aktakuza ndaj ish-kryeministrit Haradinaj

"AKK-ja e Komunat e Kosovës vlerësojnë se zoti Haradinaj ka dhënë një kontribut të madh në stabilitetin e vendit gjatë këtyre tre muajve të drejtimit të Qeverisë dhe se falënderojnë atë për bashkë-punimin e lartë me komunat e Kosovës gjatë kësaj kohe. Po ashtu Komunat e Kosovës e vlerësojnë lartë dinjitetin dhe gjestin e zotit Haradinajt".

### Sulmi ndaj presidentit Ibrahim Rugova

"AKK-ja dhe Komunat e Kosovës e dënojnë ashpër aktin e shëmtuar të sulmit ndaj presidentit Rugova. Ky është sulm i drejtpërdrejtë kundër institucioneve të Kosovës dhe institucionit më të lartë të vendit dhe pa dyshim është sulm kundër stabilitetit dhe progresit që ka arritur dhe po arrin Kosova në këtë kohë shumë të rëndësishme të zhvillimeve të saj në rrugën përfundimtare të njohjes së pavarësisë së Kosovës".

### Vdekja e Papa Gjon Pali II

"Kryetarët e Komunave të Kosovës me dhembje të thellë morën lajmin për vdekjen e Atit të Shenjtë Papa Gjon Pali II i cili gjithë jetën ia kushtoi paqes dhe lirisë së popujve. Në emër të të gjitha komunave të Kosovës duke shprehur pikëllimin me këtë rast themi se Papa Gjon Pali II ishte një mik i Kosovës dhe ka meritë të mëdha për lirinë, pavarësinë dhe demokracinë e Kosovës. I falemi kujtimit të Tij".

### Vrasja e Enver Haradinajt

"Lajmi për vrasjen e Enver Haradinajt, luftëtarit të lirisë të UÇK-së, dhe vëllait të ish-kryeministrit Ramush Haradinaj, e ka tronditur thellë AKK-në dhe komunat e Kosovës. Në emër të komunave të Kosovës AKK-ja e dënon ashpër këtë akt mizor dhe kërkon nga organet e ndjekjes që aktorët e këtij krimi të kapen dhe të dalin para drejtësisë sa më parë – thuhet në reagimin e AKK-së të nënshkruar nga u.d.kryetarit z.Ismet Beqiri.

## Udhëheqja e AKK-së mori pjesë në Kongresin e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale në Strasburg



Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës dhe kryetari i Kuvendit komunal të Prishtinës, Ismet Beqiri, kryetari i Komunës së Skenderajt, Ramadan Gashi dhe Petar Vasić, kryetar i Kuvendit komunal të Novobërdës, morën pjesë në Kongresin e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale në Strasburg. Gjatë vizitës, udhëheqja e Asociacionit të Komunave të Kosovës prezantoi aktivitetet e pushtetit lokal si dhe prioritetet e pushtetit lokal në Kosovë që e presin në të ardhmen. Në Kongresin e Autoriteteve Lokale e Rajonale në Strasburg debatoi edhe Enrico Buergi, kryetar i Konferencës së Konventës për Peizazhin Evropian, pastaj Marie Line Meaux, se-kretare e Përgjithshme e Misionit të Alpeve dhe kryetare e Grupit të Transportit, si dhe Claudie Haegi, kryetar i Fondacionit për Ekonomi dhe Zhvillim të Qëndrueshëm të Rajoneve në Forumin Evropian për Energji, Teknologji e Transport Publik e Privat.

## Qeveria e Kosovës takoi Kryetarët e Komunave



"Asociacioni i Komunave të Kosovës ka dëshmuar një efektivitet dhe gatishmëri të madhe në plotësimin e standardit tre dhe katër që kanë prioritet nëpër të gjitha komunat", deklaroi ministri i Pushtetit Lokal, z.Lutfi Haziri.

Koordinimi i aktiviteteve të komunave për një siguri më të madhe për qytetarët dhe implementimi i standardeve ishte tema e takimit të sotëm të zëvendëskryeministri i Kosovës, z.Adem Salihaj me kryetarët e Komunave të Kosovës. "Asociacioni i Komunave të Kosovës ka dëshmuar një efektivitet dhe gatishmëri të madhe në plotësimin e standardit tre dhe katër që kanë prioritet nëpër të gjitha komunat" - tha me këtë rast ministri i Pushtetit Lokal, z.Lutfi Haziri. "Ajo çka ndodhi ditëve të fundit në Kosovë nuk duhet të kuptohet si veprim i pasojave, sepse obligimi ynë ndaj qytetarëve është i madh" - u shpreh u.d. i kryetarit të AKK-së dhe kryetari i KK të Prishtinës z.Ismet Beqiri. Ai shtoi se të gjithë kryetarët e komunave kanë shprehur gatishmëri për një intensifikim të punës. "Komunat janë ato që bartin barrën kryesore për standardet dhe jemi në fazën kur brenda një muaji fillon faza tjetër e vlerësimit të standardeve. Përkundër buxhetit të vogël komunat duhet ti plotësojnë standardet e parapara në mënyrë që të shkohet drejt bisedimeve për statusin final të Kosovës" u shpreh z.Ismet Beqiri.

## AKK-ja mori pjesë në takim "Zhvillimi Ekonomik Lokal" në Bosnje dhe Hercegovinë



Delegacioni i AKK-së i kryesuar nga Drejtori Ekzekutiv i AKK-së, z.Sazan Ibrahimović mori pjesë në takim mbi "Zhvillimi Ekonomik Lokal (ZHEL)" i organizuar nga Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore në kooperim me Rrjetin e Asociacioneve të Autoriteteve Lokale të Evropës Jug-Lindore (NALAS), takim i cili u mbajt në Bërrçko (Bosnjë e Hercegovinë). Qëllimi i takimit ishte "Roli i Komunës në Zhvillimin Ekonomik Lokal" ku Asociacioni i Komunave të Kosovës para të pranishmëve pati mundësi të prezantojë punën e Komunave të Kosovës në ZHEL, problemet me të cilat komunat e Kosovës janë duke u ballafaquar rreth Zhvillimit Ekonomik Lokal si dhe aktivitetet e Asociacionit të Komunave të Kosovës në përkrahjen e ZHEL-it.

## Kryetarët e Komunave dhe ministri Shatri debatuan për shkurtime buxhetore që i kanë dëmtuar buxhetet komunale

Nën organizim të AKK-së u mbajt një takim pune i kryetarëve të komunave të Kosovës me ministrin e Ekonomisë dhe Financave z.**Haki Shatri** e ku ishin edhe ministri i Pushtetit Lokal z.**Lutfi Haziri**, drejtori i Departamentit të Buxhetit në MEF z.**Agim Krasniqi** dhe drejtori i Departamentit të Thesarit në MEF z.**Lulzim**



**Ismajli**. Qëllimi i këtij takimi ishte debati për shkurtime buxhetore të vitit 2005 që i kanë prekur buxhetet e komunave të Kosovës dhe për vështirësitë në përmbushjen e standardeve (në mungesë të buxheteve për projektet e ndryshme e që janë pjesë e përmbushjes me sukses të Standardeve për Kosovën) në përgjegjësi të Komunave të Kosovës.

Pasi u dëshiroi mirëseardhje, u.d kryetarit të AKK-së z.**Ismet Beqiri** tha se kemi shumë çka të bisedojmë dhe është kjo formë e mirë e komunikimit mes pushtetit lokal dhe atij qendror. z.Beqiri paraqiti para të pranishmëve konkluzionet që kryetarët e Komunave kishin nxjerr në një takim parapërgatitor për këtë takim.

Ministri **Haki Shatri** në fillim theksoi se “me gjithë vullnetin e dyanshëm shkurtime buxhetore nuk mund ti ndryshojmë as Ju e as ne. Buxheti për vitin 2006 do të përpilohet në bazë të projekteve dhe do të përfshihen veç ato që mund ti realizojmë”.

Në lidhje me kërkesat e komunave, ministri Shatri tha se “disa gjëra duhet të sqarohen e disa duhet të zgjidhen dhe ne jemi për të bashkëpunuar me pushtetin lokal për çka edhe e kemi vullnetin”. Ministri Shatri shtoi se “e marrë për obligim me biseduar me Komisionin Rregullativ të Prokurimit që gjithë procedurave rreth ankesave të mos zgjasin më shumë se një javë duke shprehur edhe një herë vullnetin për konsultime me kryetarët e komunave sa herë që paraqitet nevoja”.

Duke marrë fjalën në këtë takim, ministri i Pushtetit Lokal z.**Lutfi Haziri** tha se “do të bëjmë standardizimin pagave të këshilltarëve komunalë dhe Ligjin për menaxhimin e Financave Lokale si dhe do të bëhet unifikimi i mëditjeve dhe pagat e kryetarëve do të bëhen në dy kategori që të mos ketë shumë laramani”. Po ashtu ministri Haziri u premtoi kryetarëve të komunave të Kosovës se “Komunat do të jenë të parat që do të kenë mundësinë e marrjes së kredive, kurse sa i përket punësimit ai shtoi se në bazë të kriterëve për përmbushjen e standardeve ka tolerancë në këtë mes”. Kryetari i komunës së Pejës z.**Ali Lajci** pyeti se “cilat kanë qenë kriteret në përpilimin e buxheteve komunale dhe ne vetëm formalisht atëherë po e diskutojmë buxhetin e komunës në mbledhjet e KK-së”. Drejtori i departamentit të Buxhetit në MEF z.**Agim Krasniqi** theksoi se “tani me paga në sektorin publik jemi në shkallën 28 për qind e nuk guxojmë asesi ta kalojmë 30 për qindshin. Deri në vitin 2003 kemi

pasur të pakontrolluar çështjen e punësimit dhe komunat kanë pasur kriteret të ndryshme në punësim dhe koeficienta të punëtorëve për paga. Komunat kanë të drejtë në subvencione mirëpo vetëm për institucione komunale”. Duke folur për planifikimet e të hyrave komunale ai tha se “ashtu si e kanë sjellur komunat planet e tyre ashtu i kemi miratuar”. Drejtori i Departamentit të Thesarit në MEF z.**Lulzim Ismajli** theksoi se “nga subvencionet komunat mund të paguajnë mirëpo jo nga linja buxhetore e mallrave dhe shërbimeve. Kryeshefat ekzekutiv të komunave janë përgjegjës për financat publike të komunave. Thesari realizon për 24 orë kërkesat e komunave mirëpo ka raste kur ato kthehen në mungesë të të dhënave të plota dhe të sakta në mbushjen e formularëve për tërheqje të mjeteve”.



Kryetari i komunës së Kamenicës z.**Shaip Surdulli** tha se “komuna ime e cila është shembull në përmbushjen e standardeve është shpërblyer me 100 mijë euro më pak buxhet”. Kryetari i komunës së Mitrovicës z.**Faruk Spahiu** tha se “unë jam bind që ka hapësirë bashkëpunimi mes komunave dhe ministrive dhe departamenteve të tyre. Sa ië përket shkurtimeve buxhetore që u janë bërë komunave kryetari Spahiu vlerësoi se shteti bën edhe shkurtime buxhetore ku shteti e sheh të nevojshëm”.

Kryetari i komunës së Klinës z.**Ramë Manaj** vlerësoi se “ne jemi të binjakëzuar me një komunë në Evropë dhe kur ajo

komunë neve na ndihmon me mjetet të ndryshme deri në 150.000 euro ne nuk kemi qenë në gjendje me ua paguar as shpenzimet e hotelit dhe këtë ai e vlerësoi si të papranueshme në kompetencat e komunave ne aspektin e financave”.

Nënkryetari i AKK-së dhe kryetari i komunës së Skenderajt z.**Ramadan Gashi** tha se “ne

duhet të respektojmë rregulloret por duhet gjetur forma për mjete plotësuese për komuna të vogla dhe të varfra”. Kryetari i komunës së Lipjanit z.**Xhevat Olluri** pyeti “pse komunës sime nuk iu janë bartur mjetet nga viti i kaluar kur aty kanë qenë edhe participimet e qytetarëve për realizimin e projekteve të përbashkëta të komunës me komunitetin”. Kryetari i komunës së Fushë-Kosovës z.**Skënder Zogaj** tha se “këta tre muaj të këtij viti shkuan me shqetësimet se buxheti ynë mund të mbetet pa mjete në muajt e fundit të vitit. Sektor të ndryshëm të MEF-it duhet të gjejnë specifikat e komunave për një rishikim dhe analize të plotë për këta tre muaj”. Kryetari i komunës së Podujevës z.**Agim Kikaj** pyeti se “a e ka ndërmend qeveria qendrore të ndaj mjetet për standardin e kthimit i cili u kushton komunave e ato nuk kanë mjete”. Nënkryetari i komunës së Rahovecit z.**Nahit Elshani** pyeti se “a janë marrë për bazë rekomandimet e Deklaratës Parimore për Financat të AKK-së dhe IFES-it që është miratuar në konferencën e Nëntorit”. Shefi i IFES Ltd. Në Kosovë z.**Alan Packer** tha se “këtë çështje e kam përcjell me interesim të madh e ku kam pa shumë probleme në komuna. Disa çështje të thjeshta këtu s’po marrin përgjigje. Nëse shkurtime të komunave do të ishin të njëjta atëherë ndoshta nuk do të kishte problem. Unë nuk e kuptoj pse psh. Malishevës iu janë zvogëluar grantet në shërbime mallra në 68 për qind kurse Lipjanit psh., 35 për qind në paga. Më duket se asnjë pjesë e qeverisë nuk ballafaqohet me këto probleme të komunave dhe se ndikimet në buxhet mos janë bërë për edukim të komunave”. Kryetari z.**Ismet Beqiri** theksoi “nevojën e ndryshimit të problemit të mëditjeve si dhe rregullimin e çështjes së financimit për kabinetin e kryetarit të komunës si dhe ndihmesën e institucioneve qendrore për vjeljen e tatimit të qiradhënies”. Ministri z.**Haki Shatri** sqaroi edhe një herë se “mundësitë buxhetore të Kosovës janë të limituara dhe nuk ka rezerva financiare. Pajtohem për disa probleme në procedurat duhet të bisedojmë edhe më me kryeshefat ekzekutiv dhe drejtorët e Financave të komunave dhe Ministria do të marrë masa aty ku është faji i saj”.

Nga ky takim doli ideja e mbajtjes së një takimi mes Ministrisë së Financave, Kryeshefave Ekzekutiv dhe Drejtorëve të Financave nëpër komuna për të eliminuar pengesat dhe ngecjet në procedura./


## U aprovua Raporti Financiar i AKK-së për vitin 2004

Komisioni për Financa i AKK-së mbajti një takim me datën 04.04.2005 ku u shqyrtuan dhe miratuan aktivitetet financiare dhe Raporti Financiar i AKK-së për vitin 2004. Të pranishëm në këtë takim ishin z.Fadil Ferati kryetar i Komisionit për Financa të AKK-së, z.Shaip Surdulli anëtar i Komisionit, z.Sazan Ibrahimimi drejtor ekzekutiv në AKK dhe Mexhit Shaqiri - Menaxher i Financave të AKK-së. Mungoi z.Gani Krasniqi anëtar i Komisionit për Financa në AKK.

Gjatë prezantimit të Raportit Financiar të AKK-së për vitin 2004, z.Mexhit Shaqiri - Menaxher i Financave të AKK-së tha se "unë jam marrë me aktivitetet financiare të AKK-së nga data 17 maj 2004 kur edhe e kam marrë këtë detyrë". Ai në vazhdim tha se "unë kam prezantuar Raportin e pjesërishëm financiar të AKK-së (deri më datën 31 tetor 2004) në Konferencën e nëntorit të AKK-së ku të gjithë kryetarët e komunave kanë pasur rastin ta kenë atë dhe t'a shqyrtojnë". Ai shtoi se "sot po prezantoj raportin e plotë financiar të AKK-së për vitin 2004 (01.01.2004 - 31.12.2004) i cili është rast që për herë të parë po merr formën zyrtare miratimi i aktiviteteve financiare të AKK-së para Komisionit Financiar të AKK-së

i cili është përgjegjës për kontrollimin e aktiviteteve financiare të AKK-së".

Menaxheri i Financave të AKK-së elaboroi para të pranishmëve punën dhe aktivitetet financiare të AKK-së dhe tha se "të gjitha aktivitetet financiare janë të regjistruara në programin elektronik të AKK-së të quajtur QUICKEN në kompjuter me kode të veçanta. Po ashtu të gjitha faturat që kanë të bëjnë më të hyrat dhe të dalat si dhe tër-heqjen e pareve nga banka janë të regjistruara edhe në mënyrë manuale si dhe të sistemuara nëpër foldere përkatëse". Pasi anëtarët e Komisionit shqyrtuan materialet e Raportit



Financiar, z.Fadil Ferati kryetar i Komisionit kërkoi që "gjatë llogaritjes së amortizimit të shqyrtohet shkalla e amortizimit të mjeteve themelore të AKK-së". Poashtu në disa pyetje të z.Shaip Surdulli anëtar i Komisionit u përgjigj z.Mexhit Shaqiri menaxher i Financave të AKK-së i cili sqaroi gjithë rrjedhën e Raportit Financiar për vitin 2004. Më pas u aprovua në tërësi Raporti Financiar i AKK-së për vitin 2004, ku atë e nënshkruan: z.Fadil Ferati

Kryetar i Komisionit, z.Shaip Surdulli - anëtar i Komisionit, z.Sazan Ibrahimimi-Drejtor Ekzekutiv dhe z.Mexhit Shaqiri - Menaxher i Financave të AKK-së.

**Para Komisionit për Financa të AKK-së poashtu u prezentua edhe lista e komunave që i kanë kryer dhe ato që nuk i kanë kryer obligimet financiare ndaj Asociacionit të Komunave. Me këtë rast Komisioni për Financa kërkoi që komunat sa më parë t'i kryejnë obligimet e tyre në këtë drejtim.**

**Projekti i CARE International në Kosovë "Stabilizimi përmes të drejtave dhe tolerancës " (START II)"**

## Qeveria Holandeze financon projekte në 13 komuna të Kosovës



Financiar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Qeverisë së Holandës, të enjten para kryetarëve dhe kryeshefave ekzekutiv të komunave të Kosovës është prezantuar projekti i CARE International në Kosovë "Stabilizimi përmes të drejtave dhe tolerancës (START II)". Ky projekt që do të zgjas 24 muaj do të implementohet në komunën e Prishtinës, Podujevës, Obiliqit, Lipjanit, Vushtrrisë, Pejës, Klinës, Istogut, Gjakovës, Gjilanit, Kamenicës, Vitisë dhe Ferizajit.

Në këtë takim, ushtruesi i detyrës së kryetarit të AKK-së z.Ismet Beqiri tha se "këto takime dhe vetë implementimi i këtij projekti është më rëndësi në këtë fazë të vlerësimit të përbushjes së standardeve për Kosovën. Znj. Claudia Fütterknecht zëvendësdrojtore e CARE International tha se "presim bashkëpunim me komunat e Kosovës dhe të rrisim në

vazhdimësi këtë e sidomos pjesëmarrjen e komunave në këtë projekt". Përfaqësuesi i Zyrës Ndërlidhëse të Holandës në Prishtinë, z.Carel Brands si përfaqësues i qeverisë së Holandës që financon këtë projekt tha se "Njësitë komunale janë dhe do të jenë njësitë më të rëndësishme administrative. Komunat e Kosovës janë shumë të rëndësishme në zhvillim, harmoni mes pjesëve të ndryshme të popullatës, zhvillimit të infrastrukturës, arsimit e shëndetësisë. Struktura administrative e komunës është qendra e zhvillimit të Kosovës". Koordinator i projektit z.Bujar Hoxha duke prezantuar detajisht këtë projekt tha se projekti është multi sektoral dhe do të implementohet në 13 komuna të Kosovës.

Z.Hoxha shtoi se komponentët e projektit START II kanë dialogu, ngritja e kapaciteteve, ndërmarrjet e vogla e të mesme, infrastruktura

dhe aktivitete socio-kulturore. Sipas tij, kriteret për projekte të infrastrukturës janë: Propozimet e mundshme duhen të jenë bazuara në prioritetet e pranueshme të cilat promovojnë integrimin / participimin në kuadër të grupeve etnike në fshatrat e zgjedhura, Projektet duhet të rezultojnë me ndërrim / përmirësim të gjendjes së tanishme në fshatrat e përzgjedhura me qëllim që rezultati final të jetë i lartë. Shembujt mund të përsihien (por jo edhe të limitohen) në: Kycja në sistemin e ujësjellësit, Rehabilitimi i rrugëve të cilat janë të pakalueshme, Mundësia e ndërtimit të hapësirave për aktivitetet që s'mund të përdoren për momentin, Çdo zgjidhje teknike duhet të paraqitet për çdo prioritet të prezantuar, Projekt propozimi(et) duhen të jenë teknikisht të gatshme sa i përket disajnit dhe implementimit më së voni deri më 30 Shtator 2006 . Nuk parapëlqehen projektet komplekse, sepse harxhohet kohë në kompletimin teknik, dizajnim, implementim dhe menaxhim. Për projektet jo të përfunduara nuk do të kete buxhet shtesë për përfundimin e projektit në kuadër të programit START II, Komuniteti/ Komuna duhet të participojnë me 15 % në shumë totale të projektit. Gjatë prezantimit të këtij projekti me rëndësi për këto komuna kanë marrë pjesë edhe me diskutimet e tyre, z.Mu-harrem Shabani kryetar i Vushtrrisë, z.Faik Grainca kryetar i Ferizajit, z.Mustafë Pllana kryeshef i Mitrovicës, z.Arsim Janova zv.kryeshef i Prishtinës, z.Islam Thaçi kryeshef i Kamenicës, z.Shpënd Terdevaj kryeshef i Klinës, z.Muhamet Kelmendi anëtar i Bordit Ekzekutiv të Pejës dhe z.Mehmet Gërguri drejtor i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik i KK së Fushë-Kosovës.

## AKK-ja dhe Care Int. organizuan debatin me komunitete si pjesë e procesit të dialogut ndër-etnik



Asociacioni i Komunave të Kosovës në kooperim me CARE International dhe i ndihmuar nga Qeveria e Kosovës organizoi takimin e "Stabilizimi përmes realizimit të të drejtave dhe tolerancës". AKK-ja dhe CARE Int. e kanë përfunduar fazën e parë të këtij projekti në të cilën fazë është diskutuar me përfaqësuesit shqiptarë rreth dialogut ndër-etnik. Faza e dytë, pra ky është takimi i parë i fazës së dytë, proceset e dialogut ndër-etnik do të diskutohen më përfaqësuesit e komunitetit serb. Ky takim i stabilizimit përmes Realizimit të të Drejtave dhe Tolerancës kishte për qëllim t'u ndihmojë komuniteteve që ta zhvillojnë kapacitetin që në mënyrë të pavarur t'i menaxhojnë konfliktet dhe për të mundësuar dialog dhe ndërveprim konstruktiv me qëllim të krijimit të një integriteti etnik të qëndrueshëm dhe të suksesshëm. Në këtë takim proceset e dialogut ndër-etnik u diskutuan me përfaqësuesit e komunitetit serb të fshatrave të komunave të Regjionit të Gjilanit e ku përveç përfaqësuesve të komuniteteve morën pjesë edhe z.Lutfi Haziri, Ministër i Pushtetit Lokal, z.Ismet Beqiri, u.d. i kryetarit të AKK-së dhe z.Gustavo D'Angelo Drejtor i CARE Int. në Kosovë. Pas diskutimeve të gjëra nga ky takim dolën këto:

### **KONKLUZIONE:**

- Duhet punuar bashkërisht për tejkalimin e problemeve ndër-etnike. - Udhëheqësit e fshatrave luajnë një rol të rëndësishëm në krijimin e tolerancës ndër-etnike. -Dialogimi ndikon në forcimin e bashkë-punimit ndër-etnik. -Aktivitetet kulturore-rinore ndikojnë në përmirësimin e situatës ndër-etnike. -Zgjidhja e problemeve pronësore-juridike ndikon në kthimin e qëndrueshëm. -Çështjet ekonomike e sidomos punësimi është preokupim për të gjitha komunitetet. -Institucionet qendrore dhe ato lokale janë të zotuar për punë të mëtutjeshme në procesin e kthimit. -Akuzat ndaj bashkëqytetarëve pa argumente janë të pajustificueshme dhe këto çështje duhet të zgjidhen nga organet e drejtësisë. - Vullneti i mirë dhe serioz për zgjidhjen e problemeve mund të dërgoj në përmirësimin e situatës aktuale. -Institucionet komunale edhe në të ardhmen përmes Këshillave Komunale për Kthim dhe Parandalimin e Krimit do të vazhdojnë punën në realizimin e objektivave për çka edhe janë formuar këto Këshilla. -Vazhdimësia e dialogut ndër-etnik ndikon në përmirësimin e standardeve. - Përparimet të cilat janë bërë në komunat e Regjionit të Gjilanit rreth qarkullimit të lirë dhe tolerancës ndër-etnike janë shembull i mirë për tërë Kosovën. - Në takimet tjera të ftohen të gjitha komunitetet nga të gjitha komunat.

## AKK-ja vazhdon punën në grupet punuese për Standardet e Kosovës

Në kuadër të aktiviteteve për përmirësimin e Standardeve për Kosovën, Asociacioni i Komunave të Kosovës është mjaft aktiv në kuadër të grupeve punuese. Kështu AKK-ja e përfaqësuar nga drejtori ekzekutiv z.Sazan Ibrahimiri merr pjesë rregullisht në mbledhjet e Grupeve Punuese për Standarde. Gjatë muajit të fundit rol aktiv në plotësimin e formularëve ka pasur AKK-ja e cila ka dërguar të kompletuar shënimet për Strategjitë dhe projektet afatgjata të komunave që inkorporohen në zhvillimin ekonomik lokal të përcaktuar si detyra dhe obligime në Standardin e pestë. Një rol të veçantë AKK-ja ka luajtur edhe në kuadër të shënimeve për Standardin e dytë në parandalimin e krimit dhe funksionimin sa më të mirë të Këshillave Komunale për parandalimin e Krimit ku institucionet relevante janë njoftuar me kohë për të gjitha aktivitetet e përcaktuara në këtë standarde e të kryera nëpër Komunat e Kosovës.


## Përgatitet Plani Strategjik për koordinatorët komunalë për të Drejtat e Fëmijëve

Forumi për të Drejtat e Fëmijëve dhe Asociacioni i Komunave të Kosovës kanë mbajtur një seminar trajnues në Strugë. Qëllimi i këtij seminar ka qenë përpilimi dhe hartimi i një plani strategjik për koordinatorët komunalë për të Drejtat e Fëmijëve. Ky seminar ka ardhur si vazhdim i iniciativës se kryetarit të Kamenicës z. Shaip Surdullit që përmes AKK -së të organizohet një takim me kryeshefat e ekzekutiv të të gjitha komunave me qëllim të emërimit të një koordinatori për të Drejtat e Fëmijëve me orar të plotë, iniciativë kjo e cila gjatë takimit të organizuar nga Forumi dhe AKK-ja ditë më parë është mbështetur nga Kryeshefat Ekzekutiv të cilët janë pajtuar që komunat të kenë një koordinatror me orar të plotë. Gjatë hapjes së këtij seminari, znj. Juliana Olldashit, fillimisht bëri prezantimin e disa materialeve bazë mbi të drejtat e fëmijëve, siç janë Deklarata universale mbi të drejtat e fëmijëve, Konventa mbi të drejtat e fëmijëve, analiza e gjendjes së fëmijëve dhe të grave në Kosovë( Dokument i UNICEF-it), si dhe teste materiale të tjera për t'u plotësuar nga KKDF-ve. Znj. Olldashit pastaj foli rreth të drejtave të fëmijëve duke sqaruar dhe prezantuar përmbajtjen e Konventës për të Drejtat e Fëmijëve. Ajo gjithashtu sqaroi para të pranishmëve koncepte që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve dhe tha se synim i yni dhe i juaji si KKDF duhet të jetë përmirësimi i pozitës së fëmijëve dhe respektimi i të drejtave të tyre në shoqërinë kosovare.

Ditët në vazhdim të këtij seminari u përqendruan në trajnimin e KKDF në punën rreth planit strategjik dhe rëndësisë së tij. Z.Shkumbin Arifi, i cili ishte në cilësinë e trajnerit fillimisht foli rreth pikave kryesore të këtij trajnimit cilat ishin: Trajnimi mbi planifikimin strategjik, Objektivat e trajnimit, Çështjet kryesore, Çka kërkohet nga ju, Çfarë është planifikimi strategjik, Përse planifikojmë, Një plan i hartuar mirë, Studimi i organizatës, Deklarata e misionit dhe vizionit. Më pas trajnimi u përqendrua në punën në grupe të KKDF-ve nga të cilët u kërkua që të punojnë në nxjerrjen e elementeve kryesore të planit strategjik siç janë: Deklarata e misionit dhe vizionit, vlerësimi i mjedisit, qëllimet dhe objektivat, përcaktimi i çështjeve kritike, zbatimi i planit strategjik si dhe monitorimi dhe vlerësimi. Gjatë punës së tyre në grupe KKDF-të arritën që të nxjerrin deklaratën mbi Vizionin dhe Misionin ndërsa vështirësi në punën e tyre në ditët në vazhdim paraqiti përcaktimi i çështjeve kritike si dhe zhvillimi i qëllimeve dhe objektivave si dhe çështjeve tjera vijuese.

Duke marrë parasysh këto vështirësi më të cilat u përballen KKDF-gjatë punës se tyre rreth planifikimit strategjik, Forumi dhe AKK-në nxirren konkluzat dhe hapat e ardhshëm me qëllim të finalizimit të këtij plani strategjik dhe iniciativës për emërimin e KKDF me orar të plotë. Hapat e përcaktuar janë: Dërgimi i procesverbalit të të gjithë pjesëmarrësve, Përcaktimi i çështjeve kritike (Raporti i UNICEF-it, Drejtoratet, OJQ-të, QPS-të, Grupet Rajonal (OSBE-ja, UNMIK-u, SHPK-ja, TMK-ja etj.), Takimi i fokus grupit, Diskutohen çështjet me kritike, Përcaktimi i qëllimeve dhe objektivave, Përcaktimi i aktiviteteve, Draftimi i planit strategjik dhe prezantimi para koordinatrorëve, Inkorporimi i komenteve. Pas shqyrtimit të të gjithë këtyre hapave dhe avancimit të këtij dokumenti deri në finalizim, Plani strategjik do të prezantohet para kryeshefave ekzekutiv të komunave dhe institucioneve tjera relevante.

## Sa jeni të kënaqur me web-faqen e Asociacionit të Komunave të Kosovës ?



# Vlerësohet shumë e mirë web-faqja e AKK-së www.komunat-ks.net

Për tre muaj sa ka qëndruar aktive për t'u votuar një anketë në web faqen e Asociacionit të Komunave të Kosovës, rezultatet e saj tregojnë se ajo është pëlqyer në masën më të madhe. Kështu 65 për qind e atyre që kanë votuar kanë theksuar se web faqja e AKK-së është shumë e mirë. 22.5 për qind kanë vlerësuar se ajo është e mirë ndërsa vetëm 12.5 për qind kanë vlerësuar se ajo nuk është e mirë. (shih foto lartë)

Vlen të ceket se në kuadër të aktiviteteve të saja dhe të komunikimit me opinionin e jashtëm dhe të brendshëm AKK-ja ka edhe faqen e saj në Internet e cila është ndërtuar me shtrirje dhe me informacione të ndryshme. Në ueb-faqen e AKK-së do të gjeni dokumentet themelore të Asociacionit të Komunave të Kosovës, strukturën organizative, informacionet rreth akti-viteteve në

Kosovë dhe në arenën ndërkombëtare, partnerët, komisionet e AKK-së (takimet dhe konkluzat e takimeve të Komisioneve), foto galeria etj. Web-faqja e AKK-së Ju ofron publikimet e saja si Buletini, Prospektin e AKK-së, të gjitha Deklaratat Parimore etj. Në këtë faqe do të gjeni edhe të gjitha Rregulloret e UNMIK-ut dhe Ligjet e Parlamentit të Kosovës si dhe rezultatet

e zgjedhjeve lokale 2000 dhe 2002 në Kosovë si dhe janë vendosura linqet e komunave të Kosovës, institucioneve vendore qendrore të Kosovës e organizatave të jashtme, linket e mediave kosovare dhe të huaja etj. Publikimet janë të vendosura edhe në programin PDF dhe ato mund të shkarkohen. Web-faqja e AKK-së është funksionale në gjuhën shqipe, angleze dhe atë serbe.

## Vazhdon puna e Komisioneve të AKK-së

Komisionet e AKK-së kanë arritur t'i analizojnë pengesat me të cilat ballafaqohet qeveria lokale, si Komisioni për Financa Lokale, Shërbime Publike, Licencim dhe Regjistrim të Bizneseve, Kujdes Parësor Shëndetësor dhe Banim Social etj.

### Komisionit për Shërbime Publike

Është realizuar kërkesa e Komisionit për Shërbime Publike për takime të përbashkëta të kryetarëve të komunave, kryeshefave ekzekutiv dhe shefave të sektorëve për të marr informata nga MMPH mbi ligjin e ujërave dhe draft-ligjit mbi mbeturinat. Gjithashtu është konstatuar se krijimi i një strategjie komunale për përdorimin e ujit ose një vizioni të rolit të komunave në përmirësimin e përdorimit të ujit do të përmirësonte furnizimin me ujë të qytetarëve.

### Komisioni për Financa Lokale

Ka filluar menjëherë me veprime konkrete dhe takime të rëndësishme me departamentin për buxhet dhe financa të

SHPK-së dhe administratën gjyqësore lidhur me gjobat mandatare të trafikut si dhe gjobat e trafikut që paguhen përmes gjykatave. Në ndërkohë ndodhën ndryshime në të hyrat buxhetore për Komuna ku komisioni u ftua në takimin që e organizoj drejtori për buxhet dhe financa i Komunës së Gjakovës e të gjithë drejtorëve për buxhet dhe financa të Komunave të Kosovës dhe të ftuar ishin edhe drejtori i buxhetit të konsoliduar të Kosovës. Diskutimi ishte shumë i vlefshëm për të gjitha palët, dhe të gjitha palët duan të përmirësojnë situatën, duke përfshirë edhe rastet e gjobave të paguara nëpërmjet gjykatave si ato të inspeksionit dhe trafikut etj. Komunitat duan që pagesat të arkëtohen direkt në llogaritë e tyre. Një zgjidhje për këtë problem mund të ishte takimet në mes të të gjitha ministrive të involvuara dhe Ministrisë së Pushtetit Lokal. U ra dakord që Ministria për Ekonomi dhe Financa në krye me Drejtorin për Buxhet

të Konsoliduar të Kosovës, z.Agim Krasniqi të kërkojnë takim me MBPZHR, MPL, DAGJ dhe Zyrës Ligjore të UNMIK-ut lidhur me të hyrat e cekura më lart.

### Komisioni për Licencim dhe Regjistrim të Bizneseve

Ka ka ngritur problematikën e mungesës së informacionit për bizneset e regjistruara, vonesa prej 72 orësh për ndërhyrjen e policisë si dhe anashkalimi i shqyrtimit të lëndëve paditëse nga Gjykatat Komunale. Komisioni mirëpriti pjesëmarrjen e Kryetarit të Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje z.Mehmet Neziri dhe i gjykatëses znj.Biljana Rexhipi, si dhe të përfaqësuesve të SHPK-së z.Sherif Hajra dhe zëdhënësit të SHPK-së z.Refi Morina në takimi e Komisionit, si dhe kontributin e znj.Silvia Mauri nga Banka Botërore rreth projektit të tyre BETA, për përkrahje të biznesit në Kosovë. Anëtarët e Komisionit kanë organizuar takime të nivelit komunal në Suharekë, Prizren dhe Rahovec, pastaj me SHPK-në, Gjykatën ku kanë qenë të ftuar edhe kryetari i Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje z.Mehmet Neziri dhe gjykatësja znj.Biljana Rexhepi.

ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS

## BULETINI

Viti I, Nr. 9 - Mars & Prill 2005

Bordi Botues: Sazan Ibrahim, Arsim Osmani,  
Mexhit Shaqiri, Merita Krasniqi

Rr.Isa Kastrati, Nr.113 Tel&Fax: 038 / 245 - 734  
[www.komunat-ks.net](http://www.komunat-ks.net) [info@komunat-ks.net](mailto:info@komunat-ks.net)

Asociacioni i Komunave të Kosovës mbështetet nga Agjensioni Evropian për Rindërtim përmes projektit "Përkrahje decentralizimit në nivelin komunal", implementuar nga IFES Ltd.



Statusin e Vëzhguesit



Asociacioni i Komunave të Kosovës  
Association of Kosovo Municipalities  
Asociacija Kosovskih Opština



Anëtar i përhershëm